

Messer Albagaz Sh.p.k.

**Raporti i audituesit të pavarur
dhe pasqyrat financiare më dhe për
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

Përmbajtja

Raporti i Audituesve të Pavarur.....	i-iii
Pasqyra e pozicionit financiar.....	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjeragjithëpërfshirëse.....	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital.....	3
Pasqyra e flukseve të parasë.....	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare.....	5 - 24

Raporti i Audituesit të Pavaruar

Drejtuar Menaxhimit dhe Aksionerit të Messer Albagaz shpk

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Messer Albagaz shpk ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019 si dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël (kodi IESBA) të publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët dhe kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe, ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Messer Albagaz shpk për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2018 u audituan nga një auditor tjetër që shprehu një mendim të modifikuar në lidhje me ato pasqyra në datë 14 qershor 2019.

Informacion tjetër

Informacionet e tjera përfshijnë informacionin që jepet në Raportin vjetor të Shoqërisë, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesve mbi këto pasqyra. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti vjetor i Shoqërisë parashikohet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesve.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose, nëse duket se ato përmbajnë anomali materiale.

Pasi të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me palët e ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdijë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë që të arrijnë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

BDO ALBANIA SHPK

BDO ALBANIA sh.p.k.

06 korrik 2020
Tiranë, Albania


BDO ALBANIA sh.p.k.
NIPT L02407004C
TIRANA - ALBANIA



Besjana Doda
Partner Angazhimi

Shënime	Me		
	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018	
Aktivet			
Aktive afatgjata të trupëzuara	6	417,928	432,431
Aktive afatgjata të patrupëzuara	7	8,223	8,442
Aktive të dhëna me qera IFRS 16	6	2,866	
Aktivet afatgjata		429,017	440,873
Inventarët	8	23,590	36,536
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	9	95,720	93,223
Tatim fitimi i parapaguar		4,353	3,873
Parapagime dhe aktive të tjera	10	5,946	7,365
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	11	17,920	16,626
Aktivet afatshkurtra		147,529	157,623
Totali i aktiveve		576,546	598,496
Kapitali			
Kapitali aksionar	12	706,772	706,772
Rezerva Ligjore	12	6,208	6,208
Humbje të mbartura		(298,930)	(293,828)
Totali i kapitalit		414,050	419,152
Detyrimet			
Lease Liabilities IFRS 16		2,513	
Detyrimet e shtyra tatimore	19	5,509	5,984
Detyrimet afatgjata		8,022	5,984
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	13	147,142	166,336
Parapagime të marra	14	7,332	7,024
Detyrimet afatshkurtra		154,474	173,360
Totali i detyrimeve		162,496	179,344
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		576,546	598,496

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare në faqet 5 deri 24.

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga aksionari i vetëm i Shoqërisë më 01 qershor 2020 dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:


Vladimir Vladimirov
Përfaqësuesi Ligjor




Migel Zallëmi
Hartuesi

Messer Albagaz Sh.p.k.

Pasqyra e performancës dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor
Shumat në mijë Lek

	Shënim e	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018
Shitje		350,883	352,678
Kosto e shitjeve		(290,330)	(324,110)
Fitimi bruto	15	60,553	28,568
Të ardhura të tjera	16	17,830	20,705
Shpenzime të shitjes dhe shpërndarjes	17	(61,124)	(48,512)
Shpenzime administrative	18	(24,278)	(27,246)
Rezultati nga veprimtaria operative		(7,019)	(26,485)
Të ardhura financiare neto		964	5,452
Humbja para tatimit		(6,055)	(21,033)
Përfitimi i tatimit mbi fitimin	19	954	734
Humbja e vitit		(5,101)	(20,300)
Humbje të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatim fitimi		-	-
Totali i humbjes gjithëpërfshirëse të vitit		(5,101)	(20,300)

Pasqyra e performances dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare në faqet 5 deri 24.

Messer Albagaz Sh.p.k.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

Shumat në mijë Lek

	Kapital Aksionar	Rezerva Ligjore	Humbje te Mbarura	Totali
Gjendja më 1 janar 2018	706,772	6,208	(273,528)	483,650
Transaksionet me pronarët që regjistrohen direkt në kapital				
Humbje totale gjithpërfshirëse për vitin				
Humbje për vitin	-	-	(20,300)	(20,300)
Humbje të tjera gjithpërfshirëse, neto nga tatimi	-	-	-	-
Humbje totale gjithpërfshirëse për vitin	-	-	(20,300)	(20,300)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	706,772	6,208	(293,828)	419,152
Transaksionet me pronarët që regjistrohen direkt në kapital	-	-	-	-
Humbje totale gjithpërfshirëse për vitin	-	-	-	-
Humbje për vitin	-	-	(5,102)	(5,102)
Humbje të tjera gjithpërfshirëse, neto nga tatimi	-	-	-	--
Humbje totale gjithpërfshirëse për vitin	-	-	(5,102)	(5,102)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	706,772	6,208	(293,930)	414,050

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare në faqet 5 deri në 24.

Messer Albagaz Sh.p.k.

Pasqyra e flukseve të parasëpër vitin e mbyllur më 31 dhjetor

Shumat në mijë Lek

Shënime	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019</u>	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018</u>
Flukse monetare nga aktivitetet operative		
Humbja para tatimit	(6,055)	(21,033)
<i>Rregullimet për:</i>		
Amortizimin	22,608	25,004
Fitimin nga shitja e aktiveve të trupëzuara	51	(1,837)
Shpenzimin për humbjenga zhvlerësimi i të arkëtueshmeve tregtare	9	10,296
	<u>7,405</u>	<u>10,296</u>
	24,009	12,430
<i>Ndryshimet në:</i>		
- inventarë	12,946	5,717
- llogaritë e arkëtueshme	(9,902)	(31,432)
- aktive të tjera	(1,448)	1,073
- të pagueshme tregtare dhe të tjera	(19,194)	13,857
- detyrime të tjera	2,821	404
Tatimi mbi fitimin i paguar	(20)	247
Flukse neto nga aktivitetet operative	<u>9,213</u>	<u>247</u>
	9,213	2,294
Flukse monetare nga aktivitetet investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata të trupëzuara	5	(13,112)
Arkëtime nga shitja e aktiveve të trupëzuara	586	6,388
Flukse neto të përdorura në aktivitetet investuese	<u>(7,575)</u>	<u>(6,724)</u>
	(7,575)	(6,724)
Flukse monetare nga aktivitetet e financimit		
Ritja e kapitalit aksionar	19	-
Net cash used in investing activities	<u>19</u>	<u>-</u>
Flukse neto të përdorura në aktivitetet e financimit		
Rënie neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	<u>1,294</u>	<u>(4,430)</u>
Mjete monetare dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	16,626	21,056
Mjete monetare dhe ekuivalentët e saj në 31 dhjetor	11	16,626
	<u>17,920</u>	<u>16,626</u>

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare në faqet 5 deri në 24.

1. Hyrja

a) Informacion i përgjithshëm

Messer Albagaz Sh.p.k. ("Shoqëria") është një shoqëri e vendosur në Tiranë. Shoqëria është e përfshirë në prodhimin, shitjen dhe shpërndarjen e gazrave teknike, mjekësore dhe të veçanta, si dhe shitjen e pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit. Shoqëria është regjistruar në vitin 2007 dhe në 2011 u ble nga Messer Tehnogas AD, një shoqërie vendosur në Serbi. Messer Tehnogas është pronari i vetëm i Shoqërisë.

Më 31 dhjetor 2019 dhe 2018, Shoqëria ka operuar nga magazinat në Tiranë, Gjirokastrë dhe Korçë.

b) Vlerësimi i Drejtimit mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë

Shoqëria realizoi humbje neto prej 5,101 mijë Lekë (2018: 20,300 mijë Lekë) dhe më 31 dhjetor 2019 ka humbje të akumuluar prej 298,930 mijë Lekë (2018: 293,829 mijë Lekë). Kjo është kryesisht për shkak të kohës së nevojshme për zhvillimin e biznesit pas ndryshimit të pronësisë më 2011, për shkak të vonësave në marrjen e disa licensave të prodhimit dhe tregtimit, si dhe për shkak të konkurrencës vendase. Shoqëria mbështetet vazhdimisht nga kontributet e pronarit, i cili është gjithashtu edhe furnitori kryesor. Shoqëria pret që të ardhurat të rriten në vitet në vijim dhe kostot e shitjeve të zvogëlohen si rezultat i një liçence të re tregtare që ka marrë në gjysmën e parë të vitit 2019, e cila do t'i mundësojë Shoqërisë të rrisë të ardhurat nëpërmjet qasjes në klientë të rinj dhe të zvogëlojë kostot e pagueshme ndaj palëve të treta. Si rezultat, Shoqëria pret të përmirësojë marzhin bruto të fitimit dhe të realizojë fitim në vitet në vijim. Edhe pse detyrimet afatshkurtra tejkalojnë aktivet afatshkurtra, 87% (2017: 84%) e këtyre detyrimeve janë ndaj palëve të lidhura (shih shënimin 12). Drejtimi synon të shfrytëzojë kushtet e kreditimit tregtar të ofruara nga palët e lidhura dhe të vazhdojë të ketë qasje në financimin prej tyre.

Bazuar në angazhimin e Shoqërisë mëmë për të vazhduar mbështetjen ndaj Shoqërisë dhe performancës financiare të parashikuar, këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë, që supozon se Shoqëria do të jetë në gjendje të realizojë aktivet dhe të shlyejë detyrimet e saj gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë, sipas afateve përkatëse në të ardhmen e pritshme.

2. Baza e përgatitjes

a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Këto janë pasqyrat e para vjetore të Shoqërisë në të cilat janë zbatuar SNRF 16 Të ardhurat nga kontratat me klientët dhe SNRF 9 Instrumentet Financiare. Ndryshimet në politikat e rëndësishme kontabël përshkruhen në Shënimin 3.

b) Baza e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në lek Shqiptar ("Lek"), e cila është edhe monedha funksionale e Shoqërisë. Gjithë informacioni financiar paraqitet në Lek i rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, përveç rasteve kur tregohet së është paraqitur ndryshe.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse kanë ndikim. Nëveçanti, informacionet mbielementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimet kritike në aplikimin e SNRF, që kanë efekt të konsiderueshëm në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimin 5. Gjithashtu, gjykimet dhe vlerësimet e bëra në lidhje me detyrimet e mundshme paraqiten në shënimin 21 dhe gjykimet mbi zhvlerësimin e kërkesave të arkëtueshme paraqiten në shënimin 4 (f)(i) dhe shënimin 20(b).

3-Ndryshime në politikat e rëndësishme kontabël

Zbatimi i SNRF 16 “Qiratë”

Kompania ka zbatuar SNRF 16 nga 1 janari 2019. Kompania ka zgjedhur të mos riparaqesë shumat krahasuese në zbatimin e këtij standardi, dhe për këtë arsye, kërkesat e rishikuara nuk pasqyrohen në pasqyrat financiare të vitit të mëparshëm. Përkundrazi, këto ndryshime janë përpunuar në datën e aplikimit fillestar (d.m.th. 1 janar 2019) dhe janë njohur në gjendjen fillestare të kapitalit. Detaje mbi ndikimin që kanë pasur këto dy standarde janë dhënë më poshtë. Standardet e tjera të reja dhe të ndryshuara dhe interpretimet e lëshuara nga IASB nuk kanë ndikuar në kompani pasi ato ose nuk janë të rëndësishme për aktivitetet e Kompanisë ose kërkojnë një kontabilizim, që është në përputhje me politikat aktuale të kontabilitetit të Kompanisë. Për më tepër, kërkesat për dhënie të informacioneve shpjeguese në SNRF 16 nuk janë përdorur përgjithësisht për informacionin krahasues.

SNRF 16 Qiratë

Në fuqi më 1 janar 2019, SNRF 16 ka zëvendësuar SNK 16 Qiratë dhe KIRFN 4 Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban qira.

SNRF 16 siguron një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit, që kërkon njohjen e aktiveve dhe detyrimeve për të gjitha qiratë, së bashku me opsionet për të përjashtuar qiratë, kur afati i tyre është 12 muaj ose më pak, ose kur aktivi themelor ka vlerë të ulët. SNRF 16 në mënyrë të konsiderueshme e përcjell kontabilitetin e qiradhënësit në SNK 17, duke bërë dallimin midis qirave operative dhe qirave financiare. Kompania nuk ka veprimtari të konsiderueshme qiradhënie duke vepruar si qiradhënës.

Metoda e Tranzicionit dhe Instrumentet praktike të përdorura

Kompania miratoi SNRF 16 duke përdorur qasjen e modifikuar retrospektive, me njohjen e rregullimeve kalimtare në datën e aplikimit fillestar (1 Janar 2019), pa rivendosur shifrat krahasuese. Ndërmarrja zgjodhi për të përdorur instrumente praktike për të mos qenë nevoja për të rivlerësuar nëse një kontratë, është kontratë qiraje apo përmban një qira në datën e aplikimit fillestar. Kontratat e lidhura para datës së tranzicionit, të cilat nuk u identifikuan si qira nën SNK 17 dhe KIRFN 4 nuk u rivlerësuan. Përcaktimi i qirasë sipas SNRF 16 u aplikua vetëm për kontratat e lidhura ose të ndryshuara më ose pas 1 Janari 2019.

SNRF 16 parashikon disa instrumente praktike opsionale, përfshirë ato që lidhen me miratimin fillestar të standardit. Kompania ka përdorur instrumentet praktikë të mëposhtëm kur ka aplikuar SNRF 16 për qira të klasifikuara më parë si qira operative nën SNK 17:

- a) Aplikoi një normë të vetme zbritje në një portofol të qirave me karakteristika të ngjashme;
- b) Përjashtoi kostot fillestare direkte nga matja e aktiveve të përdorimit të së drejtës në datën e aplikimit fillestar për qiratë ku aktivi i së drejtës së përdorimit ishte përcaktuar sikur SNRF 16 të ishte aplikuar që nga data e fillimit;
- c) Mbështetja në vlerësimet e mëparshme nëse qiradhëniet janë të mëdha në krahasim me përgatitjen e një rishikimi të zhvlerësimit sipas SNK 36 në datën e aplikimit fillestar; dhe
- d) Aplikoi përjashtimin për të mos njohur aktivitet dhe detyrimet e përdorimit të së drejtës për qira me më pak se 12 muaj afat të qirasë të mbetur nga data e aplikimit fillestar.

Si qiramarrës, Kompania më parë ka klasifikuar qiratë si qira operative ose financiare bazuar në vlerësimin e saj nëse qiraja transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.

Sipas SNRF 16, Kompania njeh aktivitet e së drejtës së përdorimit dhe detyrimet e qirasë për shumicën e qirave. Sidoqoftë, Kompania ka zgjedhur të mos njohë aktivitet e përdorimit të së drejtës dhe detyrimet e qirasë për disa qira të aktiveve me vlerë të ulët bazuar në vlerën e aktivitet themelor kur janë qira të reja ose afatshkurtra me një afat 12 muaj ose më pak.

Matur me vlerën aktuale të pagesave të mbetura të qirasë, të zbritura duke përdorur normën rritese të huamarrjes së Kompanisë që nga 1 janari 2019.

Norma rritese e huamarrjes së kompanisë është shkalla me të cilën një huazim i ngjashëm mund të merret nga një kreditor i pavarur nën kushte të krahasueshme.

Shkalla mesatare e ponderuar e aplikuar ishte 4.43% (toka) and 4.27% (ndertesa).

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(a) Aktivet dhe detyrimet financiare

i. Aktivet financiare jo-derivative

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet si i matur me: koston e amortizuar; VDATGj - investim në instrumente borxhi; VDATGj - investim në instrumente të kapitalit; ose VDPFH. Aktivet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes së tyre fillestare, përjashtuar rastin kur Shoqëria ndryshon modelin e saj të biznesit për drejtimin e aktiveve financiare, rast kur riklasifikohen të gjitha aktivet e ndikuara.

Në njohjen fillestare të një investimi në kapital që nuk mbahet për shitje, Shoqëria mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme për të paraqitur ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë të investimit në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse (ATGj). Një vendim i tillë merret individualisht për çdo investim.

Shoqëria bën një vlerësim të objektivit të modelit të biznesit në të cilin një aktiv mbahet në nivel portofoli pasi kjo reflekton më së miri mënyrën se si drejtohet biznesi dhe informacionin që i ofrohet drejtimit. Informacioni përfshin:

Aktivitet financiar - Vlerësimi i modelit të biznesit: Politika e zbatueshme nga 1 janari 2018

- politikat dhe objektivat e deklaruara për portofolin dhe funksionimi i këtyre politikave në praktikë. Këtu përfshihet nëse strategjia e drejtimit përqendrohet në fitimin e flukseve monetare kontraktuale, duke përputhur kohëzgjatjen e aktiveve financiare me kohëzgjatjen e ndonjë detyrimi të lidhur ose daljen e flukseve monetare ose duke realizuar flukset e mjeteve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- si vlerësohet performanca e portofolit dhe si i raportohet drejtimit të Shoqërisë
- rreziqet që ndikojnë performancën e modelit të biznesit (dhe aktivet financiare të mbajtura në këtë model biznesi) dhe si menaxhohen rreziqet.

Shoqëria fillimisht njuh llogaritë e arkëtueshme tregtare e të tjera dhe depozitat në datën kur ato krijohen. Të gjitha aktivet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, datë në të cilën Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që është krijuar apo mbajtur nga Shoqëria, njihet si një aktiv apo detyrim më vete. Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pozicionin financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

ii. Llogaritjet e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar nënjë treg aktiv. Aktive të tilla njihen fillimisht me vlerën e drejtë të tregut, plus çdo kosto transaksioni që lidhet drejtpërdrejt me to. Pas njohjes fillestare llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera maten me metodën e koston së amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus çdorënie të vlerës.

iii. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përbëhen nga balancat e parave dhe depozitave pa afat me maturimin fillestar prej tre muaj ose më pak. Mjetet monetare maten me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

iv. Detyrime financiare jo-derivative

Shoqëria fillimisht njuh detyrimet financiare në datën e tregtimit, datë në të cilën Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shkarkohen, anulohen apo humbin vlefshmërinë e tyre.

Shoqëria ka këto detyrime financiare jo derivative: të pagueshmetregtare dhe të tjera.

Detyrime të tilla financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë të tregut, plus çdo kosto transaksioni që lidhet drejtpërdrejt më të. Pas njohjes fillestare këto detyrime financiare maten me metodën e koston së amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(b) Inventarët

Inventarët maten me vlerën më të ulët mes koston dhe të vlerës neto të realizueshme.

Kosto e inventarëve bazohet në metodën e koston mesatare dhe përfshin koston e blerjes së inventarëve, koston e shndërrimit dhe të tjera kosto për t'i sjellënë vendin dhe gjendjen ekzistuese.

Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit minus çdo kosto të vlerësuar për përfundimin dhe shpenzimet e shitjes.

(c) Aktivet afatgjata të trupëzuara

- *Njohja dhe matja*

Aktivitet afatgjata të trupëzuara maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Kosto përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me përgatitjen e aktiveve në gjendje pune për qëllimin e përdorimit të tyre; shpenzimet e çmontimit dhe heqjes së elementëve dhe rikthimin e tokës në gjendjen origjinale. Programet software e blerë të cilët janë pjesë tërësore në funksionalitetin e pajisjeve përkatëse, kapitalizohen si pjesë e kësaj pajisje.

Kur pjesë të një objekti të aktiveve afatgjata të trupëzuara kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si objekte të veçanta (përbërës kryesorë) të aktiveve afatgjata të trupëzuara.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e një objekti të aktiveve afatgjata të trupëzuara përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën e mbartur të ndërtesës dhe pajisjeve, dhe janë të njohura si të ardhura neto në kategorinë e të ardhurave të tjera, në fitim ose humbje.

- *Kostot vijuese*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata të trupëzuara i shtohet vlerës së mbetur të elementit nëse është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen që lidhen me këtë element do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me saktësi. Vlera kontabël e pjesës së zëvendësuar çregjistrohet. Kostot e mirëmbajtjeve ditore të aktiveve afatgjata të trupëzuara njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

- *Amortizimi*

Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën e llogaritjes mbi vlerën e mbetur dhe normat e amortizimit janë si më poshtë:

	2019	2018
• Ndërtesa	5%	5%
• Makineri, impiante dhe pajisje	7%- 20%	7%- 20%
• Bombula	5% - 11%	5% - 11%

Toka nuk amortizohet. Metodatat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen nëse është e përshtatshme.

(c) Aktive të patrupëzuara

- *Njohja dhe matja*

Aktivitet e patrupëzuara që kanë jetë të dobishme të fundme janë matur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Shpenzimet e zhvillimit kapitalizohen vetëm nëse shpenzimet mund të maten në mënyrë të besueshme, produkti ose procesi është teknikisht dhe komercialisht i realizueshëm, përfitimet e ardhshme ekonomike janë të mundshme dhe Shoqëria synon të ketë dhe ka burime të mjaftueshme për të përfunduar zhvillimin dhe për ta përdorur ose për të shitur aktivin. Përndryshe, ajo njihet në fitim ose humbje kur ndodhin. Pas njohjes fillestare, shpenzimet e zhvillimit maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(d) Aktivet afatgjata të trupëzuara (vazhdim)

- *Kostot vijuese*

Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme të trupëzuara në aktivin specifik me të cilin lidhet. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet për emrin e mirë dhe markat e krijuara brenda vendit, njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

- *Amortizimi*

Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën e reduktimit dhe norma e amortizimit është 5%. Metodatat e amortizimit, jetët e dobishme dhe vlerat e mbetura rishikohen në çdo datë raportimi dhe përshtaten nëse është e përshtatshme.

(e) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare të regjistruara në monedha të huaja në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit përzërat monetare është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të regjistruara në monedhë të huaj që maten me kosto të amortizuara, konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur kryhet transaksioni. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të regjistruara në monedhë të huaj që maten me vlerë drejtë të tregut konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë e tregut.

(f) Zhvlerësimi

i Aktivet financiare

Politika e zbatueshme nga 1 janari 2018

Shoqëria njihet për humbjet e pritshme të kredisë (HPK) për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar. Zbritja e humbjeve për zhvlerësimin e të arkëtueshmeve tregtare maten gjithmonë me vlerën e barabartë me humbjet e pritshme të kredisë përgjatë gjithë jetës së aktivitetit.

Gjatë vlerësimit nëse rreziku i kredisë i një aktivi financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare dhe gjatë vlerësimit të humbjes së pritshme të kredisë, Shoqëria konsideron informacione të arsyeshme të cilat janë të disponueshme pa kosto apo përpjekje të tepërta. Kjo përfshin informacionin cilësor dhe sasior, bazuar në përvojën historike të Shoqërisë, vlerësimin e kredisë dhe informacionin për të ardhmen.

Matja e HPK-ve

HPK-të janë vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë. Humbjet e kredisë janë vlera aktuale e diferencave në flukset monetare (d.m.th diferenca mes flukseve monetare kontraktuale dhe mjeteve monetare që Shoqëria pret të arkëtojë).

Drejtimi ka përdorur lehtësinë praktike të zbatimit të matricave të provizioneve për të matur humbjet e pritshme të kredisë përgjatë gjithë jetës të llogarive të arkëtueshme që vlerësohen në baza kolektive.

Për llogaritë e arkëtueshme që vlerësohen individualisht, drejtimi vlerëson shumën e rikuperueshme duke përdorur metoda të ndryshme, në varësi mënyrës se si pritet të rikuperohen shumatat e arkëtueshme, si p.sh.:

- shumata e rikuperueshme sipas një skenari hipotetik likuiditeti;
- shumata e skontuar e shitjes sipas metodës fluks monetar/shërbimi i borxhit;
- normat e rregulluara të provizionit (duke iu referuar normave të provizionit të përdorura për vlerësim kolektiv duke bërë përshtatje bazuar në skenarë specifikë si p.sh. kontratat me elementë të rëndësishëm të financimit).

Politika e zbatueshme nga 1 janari 2018 (vazhdim)

Paraqitja e zbritjes për HPK-të në pasqyrën e pozicionit financiar

Zbritjet për HPK-të nga aktivet financiare të matura me kosto të amortizuara i zbriten vlerës kontabël bruto të aktiveve. Për letrat me vlerë të borxhit me VDATGj, humbja e kredisë kalon në fitimin ose humbjen e periudhës dhe njihet në ATGj.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Zhvlerësimi (vazhdim)

i Aktivet financiare (vazhdim)

Fshirja

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar fshihet kur Shoqëria nuk ka pritshmëri për rikuperimin e plotë ose të pjesshëm të tij. Shoqëria nuk pret rikuperim të konsiderueshëm nga shuma e fshirë. Megjithatë, aktivet financiare të çregjistruara mund të mbeten objekt i aktiviteteve përmbarrimore për të qenë në përputhje me procedurat e Shoqërisë për rikuperimin e shumave për t'u arkëtuar.

Një aktiv financiar që nuk regjistrohet me vlerën e drejtë të tregut përmes pasqyrës së fitimit ose humbjes, vlerësohet në fund të çdo periudhe raportuese për të përcaktuar nëse ka evidence objektive që mund të jetë i zhvlerësuar. Një aktiv financiar është zhvlerësuar nëse evidencat objektive tregojnë së një ngjarje humbjeje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe se ngjarja e humbjes ka pasur një ndikim negativ në flukset e monetare të ardhshme të aktivitetit financiar që mund të maten me besueshmëri.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijë pamundësi apo vështirësi të një klienti për të realizuar pagesën, ristrukturim të një detyrimi ndaj Shoqërisë me kushte që Shoqëria nuk do të hynte në raste të tjera, ose treguese që një klient do të shpallë falimentim. Shoqëria konsideron evidencë të zhvlerësimit të llogarisë së kërkesave të arkëtueshme, si në nivel specifik të aktivitetit ashtu edhe në grup. Të gjithë klientët specifikë vlerësohen për zhvlerësim specifik.

Gjatë vlerësimit në grup, Shoqëria përdor të dhënat historike të probabilitetit të mospagesës, kohën e mbledhjes dhe shumën e humbjes së ndodhur, të rregulluar sipas gjykimeve të Drejtimit nëse kushtet e tanishme ekonomike dhe të kreditimit janë të tilla që humbjet aktuale të kenëmundësi të jenë më të mëdha apo më të vogla sesa të vlerësuara nga të dhënat historike.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe paraqiten si llogari provizioni kundrejt llogarive të arkëtueshme. Kur një ngjarje pas datës së raportimit shkakton një pakësim të shumës së zhvlerësimit, ky pakësim njihet në fitim ose humbje.

Fshirja

Shoqëria fshin një shumë të arkëtueshme (dhe çdo zbritje të lidhur me humbjet nga zhvlerësimi) kur drejtimi përcakton se të arkëtueshmet nuk janë të mbledhshme. Ky përcaktim arrihet pas shqyrtimit të informatave të tilla si përpjekje të rëndësishme që janë ndërmarrë për të arkëtuar shumën dhe se nuk ka mundësi të tjera për mbledhjen e shumës të papaguar

i Aktivet jofinanciare

Vlerat e mbartura të aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Nëse ka evidence të tillë, atëherë vlera e rikuperueshme e aktivitetit vlerësohet. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësiegjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja midis vlerës së tij nëpërdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës nëpërdorim, flukset e ardhshme monetare skontohen për të dhënë vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifikë të aktivitetit. Me qëllim testimin për zhvlerësim, aktivet që nuk mund të testohen në mënyrë individuale grupohen së bashku në njësinë më të vogël të aktiveve që gjenerojnë flukse hyrëse monetare nga përdorimi i vijueshëm që janë të pavarura nga flukset hyrëse monetare të aktiveve të tjera apo grupeve të tjera të aktiveve ("njësi gjeneruese e mjeteve monetare ose NJGJMM"). Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbartur e një aktivi ose NJGJMM e tejkalon shumën e rikuperueshme të vlerësuar. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me NJGJMM shpërndahen për të zvogëluar vlerën e mbartur të aktivitetit në njësi (grup njësis) në varësi të peshës së secilit. Humbja nga zhvlerësimi rishikohet në çdo datë raportimi për tregues që humbja është pakësuar ose nuk ekziston më. Humbja nga zhvlerësimi anulohet nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimin e përdorur për të përcaktuar vlerën e realizueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet vetëm në masën, në të cilën vlera e mbartur e aktivitetit nuk tejkalon vlerën e mbetur të tij që përcaktohet nga vlera neto e tij pas amortizimit, nëse nuk ka humbje nga zhvlerësimi.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Provizionet

Një provizion njihet kur Shoqëria, si pasojë e ngjarjeve të shkuara ka një detyrim aktual, ligjor ose konstruktiv, që mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të kërkohet një fluks dalës të mirash ekonomike për të shlyer detyrimin. Provizionet llogariten duke skontuar flukset e ardhshme monetare më një normë përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Amortizimi kohor i skontimit njihet si kosto financiare.

(h) Të ardhurat

Të ardhurat maten në bazë të shumës së specifikuar në një kontratë me një klient. Shoqëria njihet të ardhurat kur transferon kontrollin mbi një mall ose shërbim tek një klient.

Tabela në vijim jep informacion në lidhje me natyrën dhe kohën e përmbushjes së detyrimeve të performancës në kontratat me klientët, duke përfshirë kushtet e rëndësishme të pagesave dhe politikat e njohjes së të ardhurave.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(h) Të ardhurat (vazhdim)

Lloji i produktit	Natyra dhe koha e përbushjes së detyrimeve të performancës, përfshirë kushtet e rëndësishme të pagesave	Njohja e të ardhurave sipas SNRF 15 (e zbatueshme nga 1 janari 2018)	Njohja e të ardhurave sipas SNK 18 (e zbatueshme para 1 janarit 2018)
Gazrat	Klienti merr kontrollin e produkteve kur mallrat janë dorëzuar dhe janë pranuar në ambientet e tij. Faturat gjenerohen në atë moment kohor. Faturat zakonisht paguhen brenda 30 ditëve. Nuk zbatohet zbritje për produktet.	<p>Të ardhurat njihen kur mallrat janë dorëzuar dhe janë pranuar nga klienti në ambientet e tij dhe kur detyrimet përkatëse të performancës janë përbushur.</p> <p>Të ardhurat njihen në atë masë sa është shumë e mundshme që nuk do të ndodhë një përbysje e konsiderueshme në shumën e të ardhurave kumulative.</p> <p>Prandaj, sasia e të ardhurave të njohura rregullohet për kthimet e pritura, të cilat vlerësohen bazuar në të dhënat historike për llojet specifike të produkteve.</p>	<p>Të ardhurat nga shitja e produkteve gjatë aktivitetit të zakonshëm maten me vlerën e drejtë të shumës së përfituar ose të arkëtuar, neto nga kthimet dhe zbritjet tregtare. Të ardhurat njihen kur rreziqet dhe përfitimet e rëndësishme të pronësisë janë transferuar tek klienti, arkëtimi i shumës është e mundur, kostot e lidhura dhe kthimi i mundshëm i mallrave mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, nuk ka përfshirje të vazhdueshme të drejtimit me mallrat dhe shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme.</p> <p>Nëse është e mundshme që do të zbatohet zbritje dhe shuma e tyre mund të matet me besueshmëri, atëherë zbritja njihet si reduktim i të ardhurave pas njohjes sëshitjes. Koha e transferimit të rreziqeve dhe shpërblimeve ndryshon në varësi të kushteve individuale të procesit të shitjes.</p>
Shërbime	Faturat për shërbimet lëshohen në baza mujore dhe zakonisht paguhen brenda 30 ditëve.	<p>Të ardhurat njihen përgjatë kohës kur ofrohen shërbimet. Faza e përfundimit për përcaktimin e shumës së të ardhurave për t'u njohur vlerësohet bazuar mbi inspektimin e punës së kryer.</p> <p>Nëse shërbimet nën një aranzhim të vetëm janë dhënë në periudha të ndryshme raportimi, atëherë vlerësimi ndahet bazuar në çmimet e tyre individuale të shitjes. Pricemimi i pavarur i shitjes përcaktohet bazuar në çmimet e listës me të cilat Grupi shet shërbimet në transaksione të ndara.</p>	<p>Të ardhurat janënjohur në përpjesëtim me fazën e realizimit të transaksionit në datën e raportimit. Faza e realizimit vlerësohetmbi bazën e inspektimit tëpunës së kryer.</p> <p>Nëse shërbimet në një marrëveshje të vetme janë dhënë në periudha të ndryshme raportimi, atëherë shuma shpërndahet mbi baza relative të vlerës së drejtë midis shërbimeve të ndryshme.</p>

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(i) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

(j) Përfitimet e punonjësve

- *Planet e kontributeve tëpërcaktuara*

Detyrimet për kontribute të tilla për të përcaktuar planet e pensioneve njihen si shpenzime në fitim ose humbje, kur ka detyrim. Shoqëria merr pjesë në kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore që japin përfitimet e pensionit për punonjësit e saj pas daljes në pension. Autoritetet lokale janëpërgjegjëse për sigurimin dhe përcaktojnë prapun ligjor minimal për pensionet në kuadrin e një plani pensionesh të përcaktuar.

- *Përfitime afatshkurtra*

Detyrimet afatshkurtra që punonjësit përfitojnë, maten në një bazë të paskontuar dhe njihen si shpenzime në momentin që shërbimi përkatës ofrohet.

(k) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale njihet në fitim ose humbje, përveçse kur lidhet me elementë që njihen drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës aktuale është tatimi i pritshëm për t'u paguar nga të ardhurat e tatueshme, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose thelbësisht në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullimi të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm përfaqëson vlerësimin më të mirë të bërë të tatimit që pritet të paguhet ose arkëtohet dhe që reflekton pasiguritë që lidhen me tatim fitimin, nëse ka. Ky tatim llogaritet duke përdorur normën tatimore në fuqi ose të hyrë në fuqi në datën e raportimit. Tatim fitimi aktual përfshin gjithashtu çdo tatim që rezulton nga dividendët. Tatim fitimi aktual i pagueshëm ose i arkëtueshëm kompensohen vetëm në qoftë se kriteret e caktuara përmbushen. Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimi. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjen tatimore të papërdorur, kreditimet tatimore të papërdorura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën që është e mundur që të kenë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimi tatimor të realizohet. Këto zvogëlime anulohen, kur mundësia e fitimit të ardhshëm tatimor përmirësohet. Aktivet tatimore të shtyra jo të njohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen në masën që është e mundur që të ekzistojë fitim i tatueshëm në të ardhmen, mbi të cilin të zbatohet tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen mbi diferencat e përkohshme kur të kthehen, në bazë të ligjeve në fuqi ose miratuar në datën e raportimit financiar. Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do duhet të ndiqen nga mënyra se si Shoqëria pret, në datën e raportimit, të rikuperojë ose shlyejë vlerën e mbartur të aktiveve ose detyrimeve të veta. Aktiviteti tatimor i shtyrë kompensohet me detyrimin tatimor të shtyrë vetëm në qoftë se kriteret e caktuara përmbushen.

(l) Standarde dhe interpretime të reja që nuk janë adoptuarende

Ekzistojnë një numër standardesh, ndryshime në standarde dhe interpretime të cilat janë nxjerrë nga BSNK që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që Kompania ka vendosur të mos i miratojë që në fillim. Më të rëndësishmet nga këto jepen më poshtë, të cilat do të jenë të gjitha efektive për periudhën që fillon nga 1 janari 2020:

- SNK 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare dhe SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet dhe Gabimet e Kontabilitetit (Ndryshimi - Përkufizimi i Materialitetit)
- SNRF 3 Kombinimet e Biznesit (Ndryshimi - Përkufizimi i biznesit)
- Kuadri Konceptual i Rishikuar për Raportimin Financiar

Messer Albagaz shpk aktualisht është duke vlerësuar ndikimin e këtyre standardeve dhe ndryshimeve të reja të kontabilitetit.

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Disa nga politikat kontabël të Shoqërisë dhe notat shpjeguese kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime matjeje dhe/ose prezantimi bazuar në metodat në vijim. Ne rastet ku është e zbatueshme, informacion i mëtejshëm rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë është prezantuar në notat shpjeguese specifike të aktiveve dhe detyrimeve. Përveç kësaj, gjykimet e përfshira në njohjen e aktiveve tatimore të shtyra janë përkrahur në shënimin 19.

i) Provizionet dhe ekspozimet fiskale

Për të përcaktuar nëse një provizion duhet të regjistrohet, Shoqëria bën gjykime nëse ka ndonjë të dhënë të dukshme që tregon se ka ndonjë rrezik të identifikuar dhe të matshëm në flukset monetare të ardhshme, për shembullato që lidhen me tatimet dhe gjrobat. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë seka pasur një ndryshim në kushtet ekonomike kombëtare dhe rajonale që lidhen me humbje të mundshme. Drejtimipërdor vlerësimet bazuar në humbje të shkuara dhe prova objektive të zhvillimeve aktuale të ngjashme kur bën vlerësimin e flukseve të ardhshme të parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për të vlerësuar si sasinë edhe kohën e flukseve monetare të ardhshme rishikohen rregullisht për të reduktuar diferencat midis vlerësimeve të humbjeve dhe përvojës me humbjet.

ii) Vlerat e drejta

Aktivet financiare

Meqë mjetetmonetare në arkë, llogaritë në banka, llogaritë earkëtueshme tregtare dhe të tjera janë afatshkurtra, vlera e drejtë e tregut për to konsiderohet të jetëe barabartë me vlerën e mbartur. Politikat për zhvlerësimin dhe çregjistrimin janë përkrahur në shënimin 4(f).

Detyrimet financiare jo-derivative

Detyrimet financiare janë afatshkurtra dhe vlera e drejtë e tyre është njohur e barabartë me vlerën e mbartur.

iii) Matja e HPK-ve për të arkëtueshmet tregtare

Politika e zhvlerësimit është përkrahur në shënimin 4(f)(i)

iv) Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata të trupëzuara

Pavarësisht rënies së të ardhurave dhe humbjeve të përsëritura, drejtimi vlerëson se Shoqëria do të rrisë kapacitetet dhe të ardhurat dhe do të realizojë fitim në të ardhmen, në vijim tëlicencës së re tregtare të marrënë gjysmën e parë të vitit 2019 (shih shënimin 1(b)). Si rezultat, drejtimi konsideron se aktivet afatgjata të trupëzuara nuk janë të zhvlerësuar. Vlerësimi i tyre është një çështje gjykimi bazuar në përvojën, kushtet aktuale dhe pritshmëritë rreth performancës së ardhshmetë Shoqërisë.

v) Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata materiale

Vlerësimi i jetëgjatësisë së aktiveve afatgjata materiale është një çështje gjykimi e bazuar në eksperiencën me aktive të tjera të ngjashme. Përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktive konsumohen së pari përmes përdorimit. Gjithsesi, faktorë të tjerë, siç janë konsumimi nga pikëpamja teknike dhe tregtare si dhe vjetërsimi, shpesh rezultojnë në pakësimin e përfitimeve ekonomike të trupëzuara në aktive. Drejtimi vlerëson jetëgjatësinë e mbetur në përputhje me kushtet aktuale teknike të aktiveve dhe periudhën e llogaritur gjatë së cilës ato priten të sjellin përfitime për Shoqërinë. Faktorët kryesorë të mëposhtëm janë marrë në konsideratë:

(a) përdorimi i pritshëm i aktiveve;

(b) vjetërsimi i pritshëm fizik, i cili varet nga faktorët operacionalë dhe programi i mirëmbajtjes; dhe

(c) dalja nga përdorimi përse i përket anës teknike dhe tregtare që lind nga ndryshimet në kushtet e tregut.

Messer Albagaz Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat në mijëLek, nëse nuk shprehet ndryshe)

6. Aktive afatgjata të trupëzuara

	Toka	Ndërtesa	Makineri, impiante dhe pajisje	Bombula	Aktive te dhëna me qera IFRS 16	Totali
<i>Kosto</i>						
Më 1 janar 2018	184,334	122,274	198,063	80,977	-	585,648
Shtesa	-	-	11,814	1,297	-	13,111
Pakësime	-	-	6,745	(7)	-	(6,752)
Më 31 dhjetor 2018	184,334	122,274	203,132	82,267	-	592,007
Shtesa	-	-	4,013	4,511	2,866	11,390
Pakësime	-	-	(1,064)	(82)	-	(1,146)
Më 31 dhjetor 2019	184,334	122,274	206,081	86,696	2,866	602,253
<i>Amortizim i akumuluar</i>						
Më 1 janar 2018	-	(35,080)	(80,536)	(21,381)	-	(136,997)
Shpenzimi për vitin	-	(4,251)	(14,695)	(5,835)	-	(24,781)
Pakësime	-	-	2,198	4	-	2,202
Më 31 dhjetor 2018	-	(39,331)	(93,033)	(27,212)	-	(159,576)
Shpenzimi për vitin	-	(4,042)	(12,970)	(5,378)	-	(22,390)
Pakësime	-	-	493	16	-	509
Më 31 dhjetor 2019	-	(43,373)	(105,510)	(32,574)	-	(181,457)
<i>Vlera e mbartur</i>						
Më 1 janar 2018	184,334	87,194	117,527	59,596	-	448,651
Më 31 dhjetor 2018	184,334	82,943	110,099	55,055	-	432,431
Më 31 dhjetor 2019	184,334	78,901	100,571	54,122	2,866	420,794

7. Aktive afatgjata të patrupëzuara

	<u>Totali</u>
Kosto	
Më 1 janar 2018	9,135
Shtesa	-
Më 31 dhjetor 2018	<u>9,135</u>
Shtesa	-
Më 31 dhjetor 2019	9,135
Amortizim i akumuluar	
Më 1 janar 2018	(470)
Shpenzimi për vitin	(223)
Më 31 dhjetor 2018	<u>(693)</u>
Shpenzimi për vitin	(219)
Më 31 dhjetor 2019	(912)
Vlera e mbartur	
Më 1 janar 2018	<u>8,665</u>
Më 31 dhjetor 2018	<u>8,442</u>
Më 31 dhjetor 2019	8,223

Shpenzimet e amortizimit janë shpërndarë si më poshtë:

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Kosto e shitjeve	11,078	12,252
Shpenzimetë shitjes dhe shpërndarjes	10,174	11,252
Shpenzimet administrative	1,357	1,500
Totali	22,609	25,004

8. Inventarët

	<u>Me</u> <u>31 dhjetor 2019</u>	<u>Me</u> <u>31 dhjetor 2018</u>
Mallrat	12,057	35,939
Materiale të para	11,533	597
Totali	23,590	36,536

9. Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

	<u>Me</u> <u>31 dhjetor 2019</u>	<u>Me</u> <u>31 dhjetor 2018</u>
Të arkëtueshme nga palët e treta	105,118	89,192
Të arkëtueshme nga palët e lidhura (shënimi 22)	34,876	41,180
Zbritje për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme	(44,274)	(37,149)
	<u>95,440</u>	<u>93,223</u>

Lëvizja në zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme paraqitet si më poshtë:

	<u>Me</u> <u>31 dhjetor 2019</u>	<u>Me</u> <u>31 dhjetor 2018</u>
Teprica e zhvlerësimit më 1 janar	37,149	26,853
Zhvlerësimi i vitit (shënimi 17)	7,125	10,296
Më 31 dhjetor	44,274	37,149

10. Parapagime edhe aktive të tjera

	Me	Me
	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Aktive të tjera afatshkurtër	8,693	5,134
Parapagime	-	1,178
TVSH e arkëtueshme	(2,747)	1,053
Totali	5,946	7,365

11. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

	Me	Me
	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mjete monetare në banka	15,996	12,949
Mjete monetare në arkë	1,924	3,677
Totali	17,920	16,626

12. Kapitali

Më 31 dhjetor 2019 dhe 2018, kapitali aksionar i nënshkruar është i përbërë nga një aksion me vlerë nominale prej 700,272 mijë Lekë.

Aksionari i vetëm i Shoqërisë është Messer Tehnogas AD dhe kapitali aksionar më 31 dhjetor 2019 dhe 2018, ishte si më poshtë:

	Me	Me
	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Kapital i regjistruar	700,272	700,272
Kapital i paregjistruar	6,500	6,500
Totali i kapitalit aksionar	706,772	706,772

Rezerva prej 6,208 mijë Lekë (2018: 6,208 mijë Lekë) përfaqëson rezervën e krijuar me Vendim të Aksionarit më 24 shkurt 2012.

13. Të pagueshme tregtare dhe të tjera

	Me	Me
	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Detyrime ndaj palëve të lidhura (shënimi 22)	133,661	150,822
Llogaritë e pagueshme tregtare	12,714	14,264
Totali i detyrimeve financiare	146,375	165,086
Taksa të pagueshme	885	920
Detyrime ndaj personelit	10	
Shpenzime të përlllogaritura	(128)	330
Totali i detyrimeve jo-financiare	767	1,250
Totali	147,142	166,336

14. Parapagime të marra

Parapagimet përfaqësojnë garanci të vendosura nga konsumatorët për marrjen në dorëzim të bombulave të gazit, në vlerën e 7,332 mijë Lekë më 31 dhjetor 2019 (2018: 7,024 mijë Lekë).

15. Fitimi bruto

	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019</u>	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018</u>
Shitje palëve të treta	349,454	344,147
Shitje palëve të lidhura (Shënimi 22)	1,429	8,531
Shitje (i)	350,883	352,678
Kosto e shitjeve me shumicë	(177,101)	(197,707)
Kosto e shitjeve me bombula	(113,229)	(126,403)
Kosto e shitjeve	(290,330)	(324,110)
Fitimi bruto	60,553	28,568

(i) Shitjet për periudhat që përfundojnë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë të detajuara si më poshtë:

	<u>Per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2019</u>	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018</u>
Shitje të mallrave:	350,883	350,686
<i>Me shumicë</i>	130,428	124,718
<i>Gazra mjekësorë me shumicë</i>	99,178	75,195
<i>Gazra teknike</i>	82,593	15,085
<i>Gazra special</i>	15,633	110,804
<i>Gazra mjekësorë</i>	15,520	17,662
<i>Materiale</i>	7,532	7,222
Shitje të shërbimeve	-	2,009
Zbritje për klientët	-	(17)
Totali shitjeve	350,883	352,678

Shërbimet dhe produktet shiten përgjithësisht në bazë të porosive të blerjes ose kontratave që përfshijnë çmime fikse për njësi, por që zakonisht nuk përfshijnë të drejta kthimi ose detyrime të tjera thelbësore pas dorëzimit. Kontratat e shërbimeve zakonisht drejtohen nga kërkesa me bazë ditore. Shitjet, përgjithësisht faturohen pas përfundimit të kryerjes së shërbimit. Kushtet e pagesës ndryshojnë sipas llojit, vendndodhjes, produkteve ose shërbimeve të ofruara nga klienti. Afati midis faturimit dhe momentit të pagesës nuk është i rëndësishëm.

16. Të ardhura të tjera

	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019</u>	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018</u>
Shitja e aktiveve dhe shërbimeve të tjera	17,753	18,734
Fitim nga shitje e asetëve	51	1,837
Të ardhura të tjera	26	134
Totali	17,830	20,705

17. Shpenzime të shitjes dhe shpërndarjes

	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019</u>	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018</u>
Shitje	26,283	20,860
Shpërndarje	22,005	17,464
Paketim	12,836	10,188
Totali	61,124	48,512

Messer Albagaz Sh.p.k.
 Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare
 (Shumat në mijëLek, nëse nuk shprehet ndryshe)

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë:

	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019</u>	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018</u>
Paga dhe shpërblime	29,878	30,745
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	3,945	3,849
Totali	<u>33,823</u>	<u>34,594</u>

Më 31 dhjetor 2019, Shoqëria kishte 23 punonjës (2018: 23 punonjës). Shpenzimet e personelit janë ndarë sipas funksionit si më poshtë:

	<u>Per vitin e mbyllur ne 31 dhjetor 2019</u>	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018</u>
Kosto e shitjeve	15,559	15,912
Shpenzime të shitjes dhe shpërndarjes	13,868	14,184
Shpenzime administrative	4,396	4,498
Totali	<u>33,823</u>	<u>34,594</u>

18. Shpenzime administrative

	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019</u>	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018</u>
Ligjore dhe konsulencë	2,283	6,466
Shpenzimet e personelit	4,397	4,498
Udhëtimi dhe transporti	5,623	4,455
Shpenzime të tjera të zyrës	662	2,146
Mirëmbajtja dhe riparimi	1,357	1,500
Sigurime	2,199	2,010
Amortizim	752	849
Qira	1,390	1,234
Tatimet dhe doganat	2,063	3,429
Siguria	1,145	-
Gjobat	105	206
Telefoni dhe komunikimi	1,800	234
Përfaqësimi dhe donacionet	502	219
Totali	<u>24,278</u>	<u>27,246</u>

19. Tatimi mbi fitimin

	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019</u>	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018</u>
Tatim i vitit	-	-
Përfitimi/(shpenzimi) i tatimit të shtyrë mbi fitimin	954	733
Totali	<u>954</u>	<u>733</u>

Shoqëria përcakton tatimin në fund të vitit sipas legjislacionit tatimor shqiptar. Në vitin 2019 norma e tatimit ishte 15% (2018: 15%) e fitimit të tatueshëm. Tatimi i shtyrë është llogaritur duke u bazuar në normën e miratuar tatimore prej 15% (2018: 15%).

Më poshtë është rakordimi i tatimit, llogaritur me normën përkatëse me shpenzimin e tatimit:

	Norma e Tatimit	2019	Norma e Tatimit	2018
Humbje para tatimit		(6,055)		(20,300)
Llogaritja me normën 15%	15%	(908)	15%	(3,045)
Shpenzime të panjohura për qëllime tatimore	(48%)	2,906	(7%)	3,377
Ndryshim në diferencat e përkohshme	16%	(954)	3%	(734)
Humbje tatimore të mbartura	0%	-	(8%)	-
Përdorimi i humbjeve të mbartura të panjohura më parë	33%	(1,998)		(331)
	15.76%	(954)	3%	(733)

Humbjet fiskale të panjohura paraqesin humbjet e tatueshme të Shoqërisë të mbartura nga e shkuarane periudhat e ardhshme. Periudha e mbartjes së humbjeve fiskale sipas ligjit në Shqipëri është tre vjet. Humbjet e mbarturatatimore më 31 dhjetor 2019, paszbatimit të normës tatimore janë detajuar më poshtë:

Humbjet tatimore të mbartura:	Efekti i humbjeve tatimore	Efekti i përdorimit	Efekti i akumuluar i humbjeve tatimore
Viti 2019		(1,997)	1,530
Viti 2018	-	(332)	3,527
Viti 2017	3,442	-	3,859

Tatimi i shtyrë në lidhje me humbjet e mbartura tatimore nuk është njohur, sepse nuk është e sigurtë se do të ketë fitime tatimore të ardhshme kundrejt të cilave Shoqëria mund të shfrytëzojë përfitimet prej tyre.

Lëvizjet e detyrimevetatimore tështyra janë si më poshtë:

	1 janar 2018	Lëvizjet	31 dhjetor 2018	Lëvizjet	31 dhjetor 2019
Aktive afatgjata të trupëzuara	(6,718)	733	(5,984)	954	(5,030)
Detyrime tatimore të shtyrë	(6,718)	734	(5,984)	954	(5,030)

20. Administrimi i rrezikut financiar.

(a) Hyrje dhe pamje e përgjithshme

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve nga përdorimi i instrumenteve të saj financiare:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit.

Kuadri i administrimit të rrezikut

Bordi Drejtues dhe aksioneri i vetëm mban përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin dhe mbikëqyrjen e politikave të Shoqërisë për administrimin e rrezikut. Bordi gjithashtu është përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut të Shoqërisë. Politikat e administrimit të rrezikut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Shoqëria, përmes standardeve dhe procedurave të administrimit synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Messer Albagaz Sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(Shumat në mijëLek, nëse nuk shprehet ndryshe)

20.Administrimi i rrezikut financiar.(vazhdim)

Drejtimi i Shoqërisë kryen monitorimin e përditshëm për të gjitha pozicionet e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurat dhe shpenzimet, duke zbatuar praktikën më të mira. Drejtimi i bazuar në këto analiza për përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve zbaton masat në lidhje me rreziqet e kredisë, tregut dhe likuiditetit. Në këtë mënyrë Shoqëria i përgjigjet sfidave dhe mjedisit të tregut, duke ruajtur një pozitë të qëndrueshme të kapitalit dhe të likuiditetit.Veprimtaria aktuale e Shoqërisë, mbështetet nga kontributet e pronarit.

(b) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient ose një palë e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale që lindin kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë. Për qëllime të raportimit të administrimit të rrezikut, Shoqëria konsideron elementë të ekspozimit të rrezikut të kredisë, të tillë si rreziku i humbjes së aftësisë paguese individuale dhe rreziqe të tjera të klientëve.

Përgjegjësia për administrimin e rrezikut të kredisë i është deleguar manaxhmentit, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë të Kompanisë. Kompania monitoron përqendrimet e rrezikut të kredisë sipas llojit dhe vjetërsisë. Vjetërsia e llogarive të arkëtueshme nga palët e treta në datën e raportimit ishte:

	<u>2019</u>	<u>2018</u>
Jo në vonesë	38,069	24,254
Në vonesë deri në 30 ditë	2,783	1,773
Në vonesë 31 deri në 60 ditë	10,940	6,970
Në vonesë 61 deri në 90 ditë	5,765	3,673
Në vonesë 91 deri në 120 ditë	12,492	7,959
Në vonesë 121 deri në 180 ditë	10,470	3,485
Në vonesë 181 deri në 270 ditë	10,478	3,490
Në vonesëmë shumë se 270 ditë	48,997	78,768
Të arkëtueshme tregtare, bruto	139,994	130,372
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme (Shënimi 9)	-44,274	(37,149)
Shuma në fund të vitit	95,720	93,223

Të arkëtueshment nga palët e lidhura përfshijnë shumën prej 37,427 mijë Lekë (2017: 41,180 mijë Lekë), shumë kjo e vjetër mbi 365 ditë. Drejtimi beson së do jetë në gjendje të arkëtoje këto balanca dhe nuk e ka konsideruar atë si të zhvlerësuar.

Llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësuara

Llogaritë e arkëtueshme për të cilat Shoqëriapërcakton së nuk do të jete në gjendje të mbledhë të gjithë shumat e pashlyera sipas kushteve kontraktuale të marrëveshjes(ve) janë të zhvlerësuara.

Politika e çregjistrimit

Shih Shenimin 4(f)(i)

Kolaterali

Depozitat e garancisë janë vendosur nga konsumatorët kur dorëzohen bombulat e gazit (shih shënimin14).

Rreziku i likuiditetit është rreziku qëShoqëria do të hasë vështirësi në plotësimin e angazhimeve nga detyrimet e saj financiare.

21.Kushtëzime dhe angazhime

Ligjore

Në rrjedhën normale të biznesit,Shoqëriahasetme pretendimet ligjore dhe gjyqësore.Drejtimi i Shoqërisëështë i mendimit së asnjë humbje materiale nuk do të shkaktohet në lidhje me kërkesat ligjore dhe senuk ka pretendime ligjore të pazgjidhura më 31 dhjetor 2019.

Detyrimet e mundshme

Në mënyrë që të merret parasysh çdo rrezik i mundshëm i humbjeve të lidhura me ndonjë inspektim të ardhshëm tatimor dhe vlerësimin e detyrimeve tatimore nga organet tatimore, Shoqëria vlerëson detyrimet e mundshme tatimore dhe probabilitetin që detyrimet e tilla të lindin.

Drejtimbesson së nuk është aq e mundur që të mira ekonomike do të kërkohen për shlyerjen e detyrimeve të mundshme në lidhje me tatimin. Prandaj asnjë provizion shtese përrreziqe të tillatatimore nuk është njohur në këto pasqyra financiare.

Informacione të reja mund të jenë në dispozicion që të shkaktojnë ndryshimin e gjykimeve të Shoqërisënë lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve ekzistuese tatimore; ndryshimet e tilla ndikojnë shpenzimet e tatimit në periudhën që bëhen.

Angazhimet e qirasë

Shoqëriaka hyrë në marrëveshje afatshkurtra të qirasë dhe mund t'i anulojë me një afat lajmërimi prej 1 muaji. Më 31 dhjetor 2019, pagesate ardhshme minimale të paanulueshmetë qirasë, të pa skontuara janë 43 mijë Lekë (2018: 43 mijë Lekë).

22. Transaksionet me palë të lidhura

Shoqëria mëmëpërfundimtare është Messer Group GmbH. Shoqëria hyn në veprime me Mëmën, me shoqëritë e lidhura, dhe me drejtuesit ekzekutivë.

<i>Balancat dhe veprimet me palët e lidhura</i>	2019	2018
<i>Të arkëtueshme nga palët e lidhura (shënimi 9):</i>		
Messer GTM, Kosovo	30,878	33,591
Messer Tehnogas Vardar	13	3,617
Messer Cutting System GmbH.	253	253
Messer Tehnogas AD	3,020	3,061
Messer Austria		-
Messer Bulgaria	63	
Messer Tehnogas AD Niksic	650	658
	34,877	41,180
<i>Detyrime ndaj palëve të lidhura (shënimi 13):</i>		
Messer Tehnogas AD	109,169	119,756
Messer Tehnogas Vardar	20,605	21,731
Messer Austria	186	4,495
Messer Tatrugas s.p.o.l	2,406	3,598
Messer Tehnogas AD Niksic	700	709
Gaspack GmbH	395	400
Messer Bulgaria EOOD		107
Messer Group GmbH	91	
Messer Polska	109	
Messer Hungarogaz KFT		26
Messer Croatia Plin D.O.O		-
	133,661	150,822
<i>Shitje (Shënimi 15)</i>	2019	2018
Messer GTM, Kosovo		
Messer Tehnogas AD	236	2,095
Messer Group GmbH		-
Messer Tehnoplín	1,193	1,176
Messer Tehnogas AD Niksic		-
Messer Tehnogas Vardar		5,260
	1,429	8,531
<i>Shpenzime</i>	2019	2018
Kompensimet e drejtimit	3,534	4,753
Kosto e shitjeve	157,554	161,572
	161,088	166,325

23. Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojnë korrigjime apo shënime sqaruesenë pasqyrat financiare.